

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI MBROJTJE E BIMËVE



**SËMUNDJET MË TË PËRHAPURA NË KULTURËN E MOLLËS TË
KULTIVUAR NË DISA LOKALITETE TË KOSOVËS**

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Fadil MUSA

Kandidatja:

Sebahate SALLAHU

Prishtinë, Dhjetor 2022

ABSTRAKT

Patogjenët të cilët shkaktojnë dëme të mëdha në kulturën e mollës janë të shumtë, prej të cilave veçohen kroma e mollës (*Venturia inaequalis*), hiri i mollës (*Podosphaera leucotricha*), kalbëzimi i hirtë (*Botytis cinerea*), ndezja bakteriale (*Erwinia amylovorae*) dhe shumë sëmundje të tjera bakteriale dhe virusale të cilat shkaktojnë dëme të mëdha te molla.

Qëllimi i këtij punimi ka qenë: (i) Identifikimi i sëmundjeve më të përhapura në kulturen e mollës në dy rajone, (Prishtinë dhe Barilevë), (ii) Përcaktimi i ndejshmërisë të kultivarëve të mollës ndaj sëmundjeve të konstatuara, dhe (iii) Masat për menaxhimin e këtyre sëmundjeve.

Për nevojat e hulumtimit të sëmundjeve të ndryshme në kulturën e mollës, eksperimenti është vendosur gjatë vitit 2019 në dy pemishte të ngritura në dy lokalitete të ndryshme të Kosovës, në Prishtinë dhe në Barilevë. Në eksperiment janë përfshirë tre kultivarë të mollës (Delishesi i artë, Fuji dhe Granny Smith), të cilët kanë qenë të mbjellur në të dyja pemishtet ku janë kryer hulumtimet, kurse eksperimenti është realizuar në tri përsëritje sipas metodës së blloqeve të randomizuara të Fisherit.

Gjatë marrjes së mostrave sipas metodës së rastit në secilën përsëritje janë kontrolluar nga 10 trupa të mollës në interval kohore prej 10 ditësh të cilave gjatë tërë periudhës së vegjetacionit janë mbledhur lastarët dhe gjethet me qëllim të identifikimit të sëmundjeve të ndryshme. Mostrat e marra janë dërguar në laboratorin e mbrojtjes së bimëve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë, për identifikimin e sëmundjeve. Për identifikimin e llojeve të caktuara të patogjenëve dhe sëmundjeve të mollës janë përdorë Çelësa të ndryshëm fitopatologjik.

Gjatë këtyre është konstatuar prezenca e Kromës së mollës (*Venturia inaequalis*), dhe Hirit të mollës (*Podosphaera leucotricha*). Këto dy sëmundje janë paraqitur gjatë tërë vegjetacionit duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme kësaj kulture.

Frekuenca e paraqitjes së këtyre sëmundjeve ka qenë e ndryshme gjatë tërë vegjetacionit dhe në këtë drejtim numri maksimal i mostrave të konstatuara me infeksion në organet e ndryshme bimore të infektuara ka qenë i ndryshëm, varësisht nga kultivari dhe kushtet e ambientit të jashtëm. Si kultivar më i prekur nga sëmundjet ishte Fuji dhe më së paku kultivari Delishesi i artë, ndërsa kultivarët e mollës të mbjellur në komunën e Prishtinës kanë qenë më të prekur nga sëmundjet e konstatuara me këtë edhe dëmet në aspektin vizual duket se kanë qenë më të mëdha në këtë lokalitet.

Në kuadër të Mbrojtjes së integruar duhet ndërmarrë masat mbrojtëse ku përparësi duhet dhënë masave të tjera, sidomos atyre preventive sikurse janë: fidanët e shëndoshë, mbjellja e kultivarëve të qëndrueshëm apo rezistent ndaj sëmundjeve të ndryshme, masat agroteknike të rregullta etj. dhe përdorimin e preparateve kimike si alternativë të fundit.